



## Përditësim

Mirë se vini në informimin javor të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'u ofrojmë gazetarëve informacion të përditësuar mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të bërë pyetje.

Seancat gjyqësore vazhduan këtë javë në gjykimin *Hashim Thaçi, Kadri Veseli, Rexhep Selimi dhe Jakup Krasniqi*.

Të hënë, më 6 maj, Kryegjykatësi iu drejtua palëve dhe pjesëmarrësve në sallën e gjyqit me disa komente të përgjithshme lidhur me ecurinë e procesit gjyqësor dhe numrin e dëshmime të dhëna deri tani. Ai theksoi se 60 dëshmitarë kanë dhënë dëshmi në seanca gjyqësore, ndërsa dëshmitë e 45 dëshmitarëve janë pranuar me shkrim, pa paraqitjen e tyre për të dhënë dëshmi në gjykatë, duke e çuar kështu në 105 numrin e dëshmitarëve deri më 6 maj.

Kryegjykatësi tha gjithashtu se, që prej fillimit të gjykimit, Prokuroria, Mbrojtja ose Mbrojtësi i Viktimave kanë dorëzuar 427 parashtrime të protokolluara ose parashtrime me kërkesa për vendime, dhe se Trupi Gjyqësor ka lëshuar 367 vendime me shkrim ose me gojë deri tani. Duke vënë në dukje kompleksitetin e çështjes gjyqësore, gjykatësi u shprehu palëve dhe pjesëmarrësve mirënjohjen e Trupit Gjyqësor për bashkëpunimin e tyre deri tani për të ndihmuar Trupin Gjyqësor që gjykimi të jetë jo vetëm i drejtë, por edhe i shpejtë dhe efikas.

Pas kësaj, dëshmitari i 61-të filloi dëshminë në sallën e gjyqit, me masa mbrojtëse. Sipas përmbledhjes që u lexua nga Prokuroria, dëshmitari u arrestua dhe u mbajt i ndaluar nga ushtarë të UÇK-së në vende të ndryshme ndalimi të UÇK-së gjatë periudhës përkatëse.

Të martën, më 7 maj, dëshmitari i 62-të dha dëshmi përmes videolidhjes. Ky dëshmitar i mbrojtur u arrestua dhe u mbajt i ndaluar nga ushtarë të UÇK-së në fillim të 1999, sipas përmbledhjes që lexoi Prokuroria në sallën e gjyqit.

Në të njëjtën çështje gjyqësore, më 3 maj, Trupi Gjyqësor miratoi kërkesën e Prokurorisë që një dëshmitar ta dorëzonte një pjesë të dëshmisë së tij me shkrim dhe të jepte dëshmi me gojë përmes videolidhjes, këtë të premte, më 10 maj. Gjykatësit konstatuan se kjo do të kontribuonte në kryerjen e shpejtë të procesit gjyqësor sepse shkurtonte kohën e nevojshme për dhënien e dëshmisë dhe ndihmonte mirëqenien e dëshmitarit, i cili ka probleme shëndetësore të rënda. Sidoqoftë, në seancën e djeshme gjykatësit vendosën të pranonin deklaratën me shkrim të dëshmitarit, pa u marrë në pyetje nga ekipet e mbrojtjes, sikurse ishin pajtuar palët. Për rrjedhojë dëshmia përmes videolidhjes e caktuar për këtë të premte u anulua.

Po më 3 maj, Trupi Gjyqësor miratoi pjesërisht kërkesën e Prokurorisë për pranimin e dëshmime me shkrim të gjashtë dëshmitarëve të cilët nuk mund të japin dëshmi me gojë për arsye të ndryshme, përfshirë për arsye mjekësore dhe shëndetësore, si dhe për faktin që disa dëshmitarë kanë vdekur.





Seanca gjyqësore e ardhshme në çështjen *Thaçi dhe të tjerët* është caktuar për të martën, 21 maj në orën 9 të mëngjesit.

Në çështjen gjyqësore *Sabit Januzi, Ismet Bahtijari dhe Haxhi Shala*, Gjykatësi i Procedurës Paraprake më 2 maj miratoi kërkesën e z. Shala për të zgatur afatin që Gjykatësi i Procedurës Paraprake i kishte caktuar Mbrojtjes për dorëzimin e kërkesave lidhur me procesin e nxjerrjes së materialeve. Gjykatësi i Procedurës Paraprake konstatoi se janë paraqitur arsye të vlefshme, pasi z. Shala synon të kundërshtojë pranueshmërinë e një audioincizimi dhe i duhet kohë për të analizuar siç duhet të gjitha materialet përkatëse pas nxjerrjes së tyre.

Afati i ri për dorëzimin e kërkesave dhe kundërshtimeve nga Mbrojtja lidhur me procesin e nxjerrjes së materialeve është e hëna, 13 maj.

## **Pyetje nga gazetarët**

Nuk pati pyetje

